

Monitorimi i alokimeve dhe shpenzimeve për programet e buxhetimit të përgjegjshëm gjinor në buxhetin e Kosovës për vitin 2024

Përgatitur nga Elirjeta Beka dhe Nicole Farnsworth
për Rrjetin e Grave të Kosovës



Hyrje

Sipas Ligjit për Barazi Gjinore (LBGj) në Kosovë, zbatimi i buxhetimit të përgjegjshëm gjinor (BPGj) është i detyrueshëm. BPGj përfshin monitorimin e alokimeve dhe shpenzimeve dhe vlerësimin nëse shpenzimet publike kanë kontribuar në arritjen e rezultateve të barazisë gjinore. Qëllimi i këtij raporti është të analizojë dhe të vlerësojë alokimet dhe shpenzimet financiare për barazinë gjinore dhe programet e buxhetimit të përgjegjshëm gjinor në buxhetin e shtetit të Kosovës për vitin 2024. Duke u bazuar në hulumtimin e dokumenteve dhe analizën e buxhetit, raporti shqyrton në çfarë mase Qeveria e Kosovës i ka përkthyer zotimet e saj për barazi gjinore në veprime buxhetore dhe vlerëson efikasitetin dhe efektivitetin e këtyre alokimeve financiare në arritjen e objektivave të barazisë gjinore. Ky raport identifikon programet dhe sektorët që kanë marrë financim për të adresuar pabarazitë gjinore, si dhe shqyrton disponueshmërinë dhe përdorimin e të dhënave të ndara sipas gjinisë dhe shënuesve të tjerë socialë. Pas paraqitjes së metodologjisë, ky punim rishikon kornizën ligjore dhe të politikave, shqyrton alokimet dhe shpenzimet kryesore buxhetore të lidhura me barazinë gjinore në vitin 2024 dhe thekson pengesat strukturore që pengojnë gjurmimin dhe vlerësimin efektiv të shpenzimeve të përgjegjshme gjinore. Bazuar në gjetjet, raporti ofron rekomandime të bazuara në dëshmi që synojnë forcimin e transparencës, llogaridhënies dhe ndikimin e BPGj-së në nivel qendror dhe komunal.

Metodologjia

Pyetja kryesore e hulumtimit ishte: Sa është alokuar dhe shpenzuar për barazinë gjinore dhe programet e buxhetimit të përgjegjshëm gjinor në buxhetin e Kosovës për vitin 2024?¹ Nën-pyetjet përfshinin:

- Cilat ministri dhe institucione publike zbatuan programe të lidhura me gjininë dhe cilat ishin alokimet dhe shpenzimet e tyre buxhetore përkatëse?
- Cilët sektorë (p.sh., shëndetësia, arsimiti, mbrojtja sociale) kanë marrë financim të lidhur me objektivat e barazisë gjinore?
- Në çfarë mase ishin shpenzimet në përputhje me alokimet e planifikuara? Ku ekzistonin mospërputhje dhe pse?
- Kush ishin përfuturit e këtyre programeve, të ndarë sipas gjinisë, moshës, statusit të aftësisë së kufizuar dhe vendndodhjes gjeografike?²
- Me çfarë sfidash ose pengesash u përballën institucionet gjatë zbatimit dhe përcjelljes së nismave të BPGj-së?
- Sa transparente dhe llogaridhënëse ishin institucionet në raportimin dhe monitorimin e shpenzimeve të lidhura me gjininë?
- Cilat mësim mund të nxirren për të përmirësuar sistemin e BPGj-së në Kosovë në të ardhmen?

¹ Ky hulumtim është realizuar në kuadër të Rrjetit Mbikëqyrës të Buxhetimit Gjinor (RrMBGj) me mbështetje financiare nga Agjencia Austriake për Zhvillim (ADA) dhe Suedia. Pikëpamjet e shprehura këtu i përkasin autorëve dhe nuk përfaqësojnë domosdoshmërisht qëndrimet e ADA-s ose të Suedisë.

² Metodologjia rajonale e RrMBGj synonte gjithashtu të matë ndikimin, por për një vlerësim të tillë do të nevojitej një hulumtim më gjithëpërfshirës, jashtë fushëveprimit të këtij hulumtimi.

Raporti bazohet në një rishikim të kornizës ligjore dhe atë të politikave, një analizë të alokimeve dhe shpenzimeve të buxhetit shtetëror dhe komunal për vitin 2024, si dhe mbledhjen e të dhënave përmes kërkesave formale për informata. Përmes rishikimi ligjor u shqyrtuan ligjet, strategjitë dhe rregulloret kryesore që rregullojnë menaxhimin e financave publike dhe barazinë gjinore. Rishikimi i buxhetit përfshiu analizën e buxheteve kombëtare dhe komunale, duke u fokusuar në alokimet dhe të dhënat e disponueshme të shpenzimeve relevante për programet e buxhetimit të përgjegjshëm gjinor në vitin 2024. Kjo përfshinte analizën e përmbajtjes së buxheteve, dokumenteve financiare, raporteve buxhetore dhe evidencave të shpenzimeve që lidhen me programet e barazisë gjinore në vitin 2024, përfshirë komentet buxhetore. Kur informacioni i disponueshëm publikisht ishte i pamjaftueshëm, kërkesa për të dhëna buxhetore dhe të shpenzimeve iu dërguan institucioneve për të siguruar informacionin e nevojshëm për të vlerësuar alokimet dhe shpenzimet që lidhen me barazinë gjinore. Të dhënat u kërkuan nga Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve (MFPT),³ Agjencia për Barazi Gjinore (ABGj) dhe 54 zyrtarë për barazi gjinore (ZBGj) për informata rreth secilit program për barazi gjinore dhe/ose ato që ata i konsideronin të lidhura me BPGj, përfshirë buxhetet dhe shpenzimet e planifikuara për vitin 2024. Nga këto, vetëm 14 institucione ofruan të dhëna. Hulumtimi gjithashtu përdori raporte dhe dokumente zyrtare nga agjenci qeveritare, organizata joqeveritare (OJQ) dhe organizata ndërkombëtare.

Programi Excel është përdorur për analizimin e alokimeve buxhetore, shpenzimeve dhe mospërputhjeve ndërmjet shpenzimeve të planifikuara dhe atyre reale për programet që lidhen me barazinë gjinore. Grafikët dhe tabelat janë përgatitur për të paraqitur gjetjet dhe janë interpretuar për të identifikuar trendët, boshllëqet dhe modelet.

Monitorimi i alokimeve dhe shpenzimeve për vitin 2024 u kufizua nga transparenca e pamjaftueshme, si dhe nga raportimi dhe dokumentacioni që është në dispozicion për publikun. Mungesa e anekseve të publikuara të buxhetit dhe deklaratave buxhetore gjinore, kombinuar me qasjen e kufizuar në të dhëna të ndara të shpenzimeve në institucione dhe komuna, e bëri të vështirë vlerësimin se si janë përdorur resurset.

Korniza ligjore dhe e politikave

Ky seksion ofron një përmbledhje të kornizës ligjore dhe të politikave në nivel kombëtar që mbështetin BPGj-në. Në këtë seksion përshkruhen shkurtimisht ligjet, politikat, strategjitë dhe programet qeveritare që kishin objektiva të qarta për barazinë gjinore dhe alokime buxhetore në vitin 2024.

³ Në shkurt 2026, MFPT u ristrukturua dhe u bë [Ministria e Financave](#). Në këtë dokument përdoret shkurtesa MFPT duke u bazuar në emrin e saj gjatë vitit 2024.

Ligji për barazi gjinore

LBGj siguron mbrojtje më të gjerë për burra, gra dhe persona me identitet gjinor ose karakteristika seksuale të mbrojtura, duke garantuar mundësi dhe trajtim të barabartë në të gjitha fushat e jetës shoqërore, si në sektorin publik ashtu edhe në atë privat, përfshirë pjesëmarrjen politike, punësimin, arsimin, shëndetësinë, ekonominë, përfitimet sociale, sportin dhe kulturën.⁴ Ligji kërkon integrimin sistematik të perspektivës gjinore në çdo fazë të hartimit të politikave, zbatimit dhe vlerësimit, një proces i njohur si integrimi gjinor. BPGj është një proces sistematik që siguron që fondet publike të alokohen dhe shpenzohen në mënyra që adresojnë nevojat e veçanta të grave, burrave, vajzave dhe djemve, bazuar në analizë gjinore. LBGj e parasheh BPGj-në si kërkesë ligjore për të gjitha institucionet publike dhe mosrespektimi i kësaj përbën shkelje të dënueshme. Ligji kërkon gjithashtu që institucionet të dorëzojnë statistika të ndara sipas gjinisë në Agjencinë e Statistikave të Kosovës (ASK). Në rast se institucionet nuk veprojnë sipas këtij detyrimi, ato dënohen me gjoba që variojnë nga 300 euro deri në 500 euro, me të ardhurat që transferohen në buxhetin e Kosovës. LBGj përcakton gjithashtu arkitekturën institucionale të Kosovës për avancimin e barazisë gjinore, e cila përfshin ABGj-në në kuadër të Zyrës së Kryeministrit (ZKM), ZBGj në ministri dhe komuna dhe një komision parlamentar për të drejtat e njeriut, barazinë gjinore dhe çështje të ndërlidhura. LBGj kërkon që Qeveria të miratojë Programin e Kosovës për Barazi Gjinore (PKBGj) dhe të raportojë për të. Ligji është **transformues** në aspektin **gjinor**.

ZBGj-të janë përgjegjës për integrimin gjinor të ligjeve dhe politikave, përfshirë buxhetet, si dhe për bashkëpunimin me ABGj-në për përgatitjen e raporteve vjetore të zbatimit. Megjithatë, shpesh u caktohen detyra jashtë mandatit të tyre, çka ua kufizon aftësinë për të përmbushur përgjegjësitë e tyre.⁵ Kjo përbën shkelje të LBGj-së dhe të rregullores për detyrat dhe përgjegjësitë e zyrtarëve për barazi gjinore në ministri dhe komuna. Në vitin 2024, disa ministri nuk kishin të emëruar ZBGj, përfshirë Ministrinë e Kulturës, Rinisë dhe Sportit (MKRS), MFPT-në, Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal (MAPL) dhe Ministrinë e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë. ZBGj në Ministrinë e Punëve të Brendshme mbulonte gjithashtu edhe Ministrinë e Administratës Publike, gjë që e dobësonte kapacitetin e saj.⁶ Disa ZBGj nuk kishin trajnim të mjaftueshëm, autoritet, kohë dhe mbështetje institucionale për të kryer funksionet e tyre në mënyrë kuptimplote dhe efektive.⁷



Buxheti gjinor - është zbatimi i integrit gjinor në procesin buxhetor. Kjo do të thotë vlerësim i buxheteve nga pikëpamja e gjinisë, në rastin kur çështja gjinore është marrë parasysh në të gjitha nivelet e procesit buxhetor, të hyrave dhe shpenzimeve të ristrukturimit me qëllim të promovimit të barazisë së femrave dhe meshkujve;

- Ligji për barazi gjinore

⁴ Kuvendi i Republikës së Kosovës, [Ligji Nr. 05/L-020 për Barazi Gjinore](#), 2015, qasur më 28 tetor 2025.

⁵ UN Women, [Kosovo Gender Country Profile 2024](#) [Profili gjinor i Kosovës] 2024; Komisioni Evropian, [Kosovo 2025 Report](#) [Raporti për Kosovën 2025].

⁶ Po aty.

⁷ Komisioni Evropian, [Kosovo 2025 Report](#) [Raporti për Kosovën 2025]

Në përgjithësi, Komisioni Evropian (KE) ka konstatuar se zhvillimi profesional i nëpunësve civilë është joefikas,⁸ gjë që mund të ndikojë në zbatimin e BPGj-së. Kërkesat e LBGj-së për BPGj-në nuk zbatohen gjithmonë nga zyrtarët financiarë në organizatat buxhetore ose nuk kontrollohen nga MFPT për të siguruar përputhshmërinë me ligjin. Kjo ndodh kryesisht sepse BPGj ende nuk është institucionalizuar plotësisht në legjislacionin bazë të menaxhimit të financave publike. Integrimi i tij në legjislacion do ta bënte zbatimin e detyrueshëm, do të forconte mekanizmat për sigurimin e përputhshmërisë me ligjin dhe do të qartësonte përgjegjësitë institucionale për zbatim dhe mbikëqyrje.

Ligji për menaxhimin e financave publike dhe përgjegjësinë

Ky ligj përcakton përgjegjësinë e Ministrisë së Ekonomisë dhe Financave (tani MFPT) për menaxhimin e Fondit të Konsoliduar të Kosovës.⁹ Ai përshkruan detyrimet e organizatave buxhetore në përgatitjen e buxheteve dhe të MFPT-së në rishikimin e tyre, përfshirë afatet kohore.

Organizatat buxhetore duhet të dorëzojnë pasqyra financiare të paaudituar brenda 30 ditëve pas përfundimit të vitit fiskal dhe raporte vjetore brenda një muaji pas pranimit të pasqyrave financiare të audituara. Ministri duhet të përgatisë raporte tremujore për Kuvendin brenda 30 ditëve nga përfundimi i çdo tremujori, si dhe një raport përfundimtar të barazimit të buxhetit deri më 31 mars, i cili mbulon vitin e kaluar dhe dy vitet fiskale paraprake. Auditori i përgjithshëm është përgjegjës për auditimin e pasqyrave financiare të organizatave buxhetore dhe ndërmarrjeve publike, duke shprehur mendim nëse pasqyrat financiare paraqesin një pamje të vërtetë dhe të drejtë të financave.

Ligji është **neutral** në aspektin **gjignor**. Megjithëse BPGj-ja kërkohet nga LBGj, ky ligj nuk e trajton BPGj-në ose nuk e institucionalizon si pjesë të procesit të menaxhimit të financave publike. Ky lëshim pengon institucionalizimin e BPGj-së në sistemet e menaxhimit të financave publike dhe e dobëson zbatimin e tij. Në raportin e tij për Kosovën, KE ka rekomanduar rishikimin e legjislacionit për menaxhimin e financave publike për ta harmonizuar atë me standardet ndërkombëtare.¹⁰ Siç diskutohet më poshtë, Qeveria ka miratuar një koncept-dokument për BPGj-në, por hapat e paraparë ende nuk janë zbatuar.

Ligji për financat e pushtetit lokal

Sipas këtij ligji, komunat kanë autonomi financiare dhe duhet të sigurojnë burime të mjaftueshme për të përmbushur kompetencat e tyre sipas Kushtetutës dhe ligjit për vetëqeverisjen lokale.¹¹ Komunat mund të gjenerojnë të ardhura vetë ose t'i sigurojnë ato përmes granteve qeveritare, transfereve për kompetencat e deleguara, granteve të jashtëzakonshme, ndihmës nga Serbia dhe huamarrjes. Ata nuk mund të vendosin tatime të tjera, përveç tatimit mbi pasuritë e paluajtshme, dhe detyrat e tjera janë të ndaluara, përveç nëse delegohen shprehimisht nga qeveria qendrore. Të hyrat vetanake mund të përfshijnë taksa komunale, tarifa (p.sh., për licenca biznesi, licenca profesionale, automjete motorike, leje

⁸ KE, [Kosovo 2024 Report](#) [Raporti për Kosovën 2024], f.25.

⁹ Kuvendi i Republikës së Kosovës, [Ligji Nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë](#), 2008, qasur më 25 tetor 2025.

¹⁰ KE, [Kosovo 2024 Report](#) [Raporti për Kosovën], 2024, f.5.

¹¹ Kuvendi i Republikës së Kosovës, [Ligji Nr. 03/L-049 për Financat e Pushtetit Lokal](#), 2008.

ndërtimi ose parkim), gjoba trafiku, pagesa nga përdoruesit, qira, të ardhura nga shitja e aseteve, bashkë-pagesa për arsim dhe shëndetësi, interesa nga depozitat, si dhe grante ose donacione të huaja. Këto mund të krijojnë të ardhura të diversifikuara, që u mundësojnë komunave të mbulojnë shpenzimet e zakonshme dhe të jashtëzakonshme.

Ligji krijon një sistem të granteve për të mbështetur të hyrat komunale. Grantet operative përfshijnë grantin e përgjithshëm, i cili mund të përdoret për çdo kompetencë komunale dhe grantet specifike për arsim dhe shëndetësi. Në përgjithësi, granti i përgjithshëm përbën 10% të të hyrave totale të qeverisë qendrore. Ky grant alokohet duke përdorur një formulë që merr parasysh madhësinë e popullsisë së komunës, popullsinë e pakicave, statusin shumicë-pakicë dhe madhësinë e territorit. Grantet specifike për shëndetësi dhe arsim alokohen çdo vit nga Komisioni i Granteve bazuar në formula që marrin parasysh regjistrimin e nxënësve, numrin e mësimdhënësve dhe treguesit e shëndetit-popullsisë.

Ligji është **neutral** në aspektin **gjinor** dhe nuk parashikon BPGj-në, megjithëse pabarazitë gjinore të lidhura me shpenzimet komunale, përfshirë kujdesin shëndetësor dhe arsimin, mund të ndikojnë në kostot.

Ligji për prokurimin publik

Ky ligj synon të sigurojë përdorimin efikas, ekonomik, transparent dhe të drejtë të fondeve publike, duke ruajtur integritetin dhe llogaridhënien e zyrtarëve publikë.¹² Ai zbatohet për të gjitha aktivitetet e prokurimit, përveç disa kontratave të lidhura me mbrojtjen, atyre të rregulluara nga marrëveshjet ndërkombëtare të financimit dhe disa kategorive të tjera. Ligji përcakton parimet e përgjithshme të mosdiskriminimit, trajtimit të barabartë dhe transparencës, të cilat duhet të respektohen gjatë prokurimit. Para fillimit të çdo prokurimi, zyrtari kryesor administrativ duhet të kryejë një vlerësim formal të nevojave, të konfirmojë disponueshmërinë e fondeve dhe të përgatisë një “Deklaratë të nevojave dhe përcaktimit të disponueshmërisë së fondeve” të nënshkruar për miratimin e Zyrtarit Autorizues. Kontratat jepen ose ofertuesit me çmimin më të ulët të pranueshëm ose ofertës më të favorshme ekonomike, bazuar në kriteret objektive dhe peshim të qartë të kriterëve. Ligji parashikon që:

Autoriteti kontraktues mund të vendosë, ndër të tjera, kushte specifike në kontratë që lejojnë marrjen parasysh të objektivave sociale në mënyrë opsionale, si vijon:

- 2.1 detyrimi për të punësuar persona të papunë, veçanërisht ata që janë papunë për një periudhë të gjatë;
- 2.2. detyrimi për të punësuar persona me aftësi të kufizuara;
- 2.3. detyrimi për të krijuar programe trajnimi për të papunët ose për të rinjtë gjatë zbatimit të kontratës;
- 2.4. detyrimi për të zbatuar, gjatë zbatimit të kontratës, masa të dizajnuara për të promovuar barazinë gjinore ose diversitetin mbi baza të tjera;
- 2.5. detyrimi për të respektuar përmbajtjen e konventave themelore të [Organizata Ndërkombëtare e Punës] ONP-së gjatë zbatimit të kontratës, nëse këto dispozita nuk zbatohen në ligjin përkatës.

¹² Kuvendi i Republikës së Kosovës, [Ligji Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik në Republikën e Kosovës](#) i ndryshuar dhe plotësuar me [Ligjin Nr. 04/L-237](#), [Ligjin Nr. 05/L-068](#) dhe [Ligjin Nr. 05/L-092](#), 2016.

Këto masa sigurojnë përfshirjen e barazisë gjinore gjatë proceseve të prokurimit dhe përdorimit e masave afirmative në përputhje me LBGj. Për më tepër, neni 4(5) përcakton se “përemri “ai” dhe mbiemri “i tij” vlejnë në mënyrë të barabartë për secilën gjini”, duke ruajtur një rregull mashkullor si parazgjedhje, në vend që të përdoret gjuhë neutrale gjinore.

Prandaj, Ligji është **negativ** në aspektin **gjinor**, duke forcuar normat dhe stereotipet gjinore. Ai nuk i referohet BPGj-së, megjithëse analiza gjinore mund të kërkohej në vlerësimin e nevojave dhe të përdoret për të orientuar objektivat e kontratës dhe masat afirmative.

Ligji për auditorin e përgjithshëm dhe zyrën kombëtare të auditimit

Me këtë ligj u themelua Zyra Kombëtare e Auditimit (ZKA) si institucion të pavarur për të ndihmuar auditorin e përgjithshëm në kryerjen e detyrave të përcaktuara në Kushtetutë dhe në standardet ndërkombëtarisht të njohura të auditimit të sektorit publik.¹³ ZKA është e pavarur në aspektin funksional, financiar dhe operativ dhe nuk mund t’i nënshtrohet udhëheqjes ose ndikimit nga asnjë person apo organ. Zyra është e detyruar të veprojë me transparencë të plotë, duke publikuar në [faqen e saj të internetit](#) të gjitha raportet individuale të auditimit, raportin vjetor të auditimit, raportin vjetor të performancës dhe udhëzimet e brendshme

Mandati i auditimit të ZKA-së përfshin të gjitha aktivitetet financiare, administrative dhe të tjera të entiteteve të sektorit publik, duke i dhënë asaj të drejtën të ndjekë fondet publike deri te përfuturi përfundimtar. Ajo duhet të kryejë çdo vit auditime statutores të rregullsisë të Raportit të Buxhetit të Qeverisë, të organizatave buxhetore dhe të ndërmarrjeve publike. Gjithashtu mund të kryejë auditime të performancës, auditime të ndërmjetme dhe auditime ad hoc, në përputhje me standardet e Organizatës Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit. Aktivitetet e auditimit udhëhiqen nga një plan strategjik i auditimit trevjeçar, i cili përditësohet çdo vit. Auditori i përgjithshëm duhet t’i dorëzojë pasqyrat financiare vjetore Qeverisë dhe një raport vjetor të performancës Kuvendit deri në fund të prillit, duke publikuar raportet përfundimtare të auditimit brenda një dite nga lëshimi i tyre. Entitetet e audituara janë të detyruara t’i përgjigjen raportit përfundimtar brenda tridhjetë ditëve, duke përshkruar se si do t’i zbatojnë rekomandimet e ZKA-së. Ligji përdor gjuhë gjithëpërfshirëse gjinore. Ai i referohet auditorit të përgjithshëm si “një person” dhe përdor në mënyrë të përsëritur përemra të kombinuar (“ai/ajo” ose “i tij/saj”).

Megjithatë, ligji nuk përmban dispozita thelbësore që adresojnë barazinë gjinore ose kritere specifike gjinore të auditimit. Prandaj, ai është i **ndjeshëm** në aspektin **gjinor** në gjuhë, por jo i përgjegjshëm gjinor; nuk përfshin objektiva apo kërkesa të qarta të fokusuara në gjini.

Në total, 127 auditime u kryen gjatë sezonit 2024/2025, duke përfshirë auditime financiare, të përputhshmërisë dhe të performancës për nëntë ndërmarrje publike, 87 organizata buxhetore dhe projekte të shumta. Raporti vjetor i auditimit për vitin 2024 mbi zbatimin e ligjit të buxhetit për vitin 2024 tregon se buxheti i shtetit u zbatua në 94% të shumës së planifikuar prej 3.436 miliardë euro, me 3.234 miliardë euro të realizuara, që përfaqëson një rritje prej 13% të të hyrave krahasuar me vitin 2023. Balanca fiskale kaloi nga një deficit i parashikuar prej 211.316 milionë euro në një suficit prej 52.836 milionë euro pas zbatimit. Kjo do të thotë se kufiri i deficitit u respektua dhe u arrit një suficit modest. Auditimi gjithashtu identifikoi pasaktësi materiale: 35.254 milionë euro shpenzime ishin klasifikuar gabimisht, 30.480 milionë euro aset

¹³ Kuvendi i Republikës së Kosovës, [Ligji Nr. 05/L-055 për Auditorin e Përgjithshëm dhe Zyrën Kombëtare të Auditimit të Republikës së Kosovës](#), 2016.

kapitale ishin të mbivlerësuara, 2.046 milionë euro detyrime të pagueshme ishin të nënvlerësuara dhe 4.230 milionë euro detyrime kontingjente ishin të mbivlerësuara. Auditimi nxori 771 rekomandime, prej të cilave 205 në nivel qendror, 413 në nivel lokal dhe 153 për ndërmarrje publike. Rekomandimet kryesore u përqendruan në përmirësimin e klasifikimit të shpenzimeve, inventarizimin e asetëve, procedurat e prokurimit dhe disiplinën në shlyerjen e borxhit.

Raporti është **neutral** në aspektin **gjinor**; ai nuk përmban asnjë diskutim për çështje të lidhura me gjininë dhe në seksionet e audituara nuk paraqiten referenca për gjininë apo analizë gjinore. Ndërkohë, në vitin 2024, ZKA përgatiti një raport të përbashkët për Shqipërinë dhe Kosovën të titulluar “Auditim i përbashkët i performancës: Barazia gjinore dhe fuqizimi i grave nga zonat rurale përmes përfshirjes së tyre në tregun e punës”.¹⁴

Në raportin e tij për Kosovën, KE rekomandoi përmirësimin e bashkëpunimit ndërmjet ZKA-së dhe Kuvendit, duke forcuar mbikëqyrjen parlamentare të zbatimit të buxhetit dhe duke siguruar zbatimin dhe ndjekjen e vazhdueshme dhe efektive të rekomandimeve të auditimit të ZKA-së.¹⁵ Kjo mund të përfshijë gjithashtu konsiderimin e BPGj-së gjatë auditimit.

Korniza afatmesme e shpenzimeve

Ligji për menaxhimin e financave publike dhe përgjegjësitë e obligon MFPT-në të përgatisë kornizën afatmesme të shpenzimeve (KASH), e cila përshkruan parashikimet makroekonomike dhe fiskale, vlerësimet e të hyrave dhe shpenzimeve, si dhe projeksionet e shërbimit të borxhit për vitin fiskal të ardhshëm dhe dy vitet pasuese. Ajo ofron bazën analitike për buxhetin e konsoliduar dhe për ligjin vjetor të ndarjeve buxhetore. KASH duhet të hartohet në kohë për t’u dorëzuar në Kuvend sa më shpejt që të jetë e mundur dhe jo më vonë se 30 prilli i vitit që i paraprin zbatimit të saj.

KASH 2024–2026 përfshin konsiderata gjinore në disa shtylla strategjike.¹⁶ Në shtyllën e drejtësisë, korniza përcakton objektiva që synojnë përmirësimin e sigurisë së grave dhe të drejtave të tyre ekonomike. Veprimet specifike përfshijnë “zhvillimin e politikave dhe legjislacionit për rritjen e profesionalizmit në drejtësi”, “fuqizimin e profesioneve të lira juridike” dhe “plotësimin e kornizës ligjore për mbrojtjen nga dhuna në familje dhe dhuna me bazë gjinore”, së bashku me masa për të “përmirësuar qasjen e grave në pronë përmes zbatimit të masave afirmative”. Këto objektiva pasqyrojnë fokusin strategjik të qeverisë në luftimin e dhunës me bazë gjinore dhe në forcimin e të drejtave ligjore dhe pronësore të grave. Teksti nuk ofron objektiva numerike ose tregues të performancës për këto qëllime.

Brenda shtyllës së qeverisjes së mirë, KASH përmend buxhetimin gjinor si një element kyç të reformës së financave publike. Dokumenti bën thirrje për “buxhetimin gjinor në institucionet qendrore dhe lokale” si pjesë e një grupi më të gjerë objektivash në fushën e financave publike, siç janë forcimi i disiplinës fiskale, përmirësimi i efikasitetit alokues dhe forcimi i kontrolleve të brendshme. Megjithatë, korniza nuk specifikon objektiva të matshme ose tregues për të ndjekur progresin në buxhetimin gjinor.

Prioritetet horizontale gjithashtu theksojnë se qeveria është e përkushtuar për “avancimin e perspektivës gjinore dhe mbështetjen e aktivizimit ekonomik” dhe për “luftimin e

¹⁴ ZKA, [Raport i përbashkët. Auditim i përbashkët i performancës: Barazia gjinore dhe fuqizimi i grave nga zonat rurale përmes përfshirjes së tyre në tregun e punës](#), 2024.

¹⁵ KE, [Kosovo Report 2024](#) [Raporti për Kosovën] 2024, f. 10.

¹⁶ MFPT, [Korniza afatmesme e shpenzimeve](#), 2023.

dhunës në familje dhe formave të tjera të diskriminimit”, si pjesë e agjendës së saj gjithëpërfshirëse. Kjo e përforcon dimensionin gjinor si një temë ndërsektoriale; megjithatë, në KASH nuk janë të përcaktuara objektiva ose tregues të qartë për këtë fushë.

Strategjia për menaxhimin e financave publike të Republikës së Kosovës 2022–2026

SMFP 2022–2026 udhëzon reformën e administratës publike në Kosovë dhe synon të modernizojë sistemin e menaxhimit të financave publike (MFP) të vendit në përputhje me Strategjinë Kombëtare për Zhvillim 2030 dhe objektivat e integritit në Bashkimin Evropian (BE).¹⁷ Ajo synon të forcojë disiplinën fiskale, të përmirësojë alokimin strategjik dhe efikasitetin operacional të burimeve publike, si dhe të ndërtojë një mjedis të digjitalizuar dhe transparent për MFP-në. Duke ndërlidhur KASH-in, ligjet e buxhetit dhe strategjitë sektoriale, SMFP synon të sigurojë që të gjitha shpenzimet publike të jenë në përputhje me prioritetet e qeverisë dhe të kontribuojnë në zhvillimin e qëndrueshëm socioekonomik. Strategjia ka katër objektiva strategjike: (1) sigurimin e disiplinës fiskale të qëndrueshme, (2) përmirësimin e mëtejshëm të efikasitetit të alokimit, (3) përmirësimin e efikasitetit operacional dhe (4) forcimin e kapitalit njerëzor dhe infrastrukturës së teknologjisë së informacionit dhe komunikimit (TIK) për një sistem të digjitalizuar dhe transparent të MFP. Së bashku, këto objektiva synojnë të reduktojnë rreziqet fiskale, të përmirësojnë mekanizmat e auditimit dhe monitorimit dhe të rrisin besueshmërinë dhe efektivitetin e MFP.

Kostoja totale e zbatimit të SMFP për periudhën 2022–2024 është vlerësuar në 16.4 milionë euro, me Qeverinë e Kosovës që mbulon 53.6% (8.8 milionë euro) dhe donatorët që sigurojnë 32.0% (5.3 milionë euro), duke lënë një boshllëk financimi prej rreth 2.4 milionë euro (14.4%). Komponenti më i financuar është objektivi specifik 4.1 i lidhur me TIK-un, i cili përbën 59.1% të financimit total të strategjisë (rreth 9.7 milionë euro) dhe mbështet zhvillimin e një sistemi të integruar të menaxhimit të informacionit për MFP.

Strategjia nuk përmban referencë të qartë për BPGj dhe është **neutrale** në aspektin **gjinor**. Megjithatë, përmirësimi i institucionalizimit të BPGj-së do të ishte në përputhje me LBGj-në, si dhe me Planin e Veprimit për Barazi Gjinore të BE-së III, i cili synon të përmirësojë BPGj-në në vendet përkatëse. Strategjia mund të kishte përfshirë udhëzime për institucionalizimin e BPGj-së në MFP, duke avancuar kapacitetet e zyrtarëve të financave publike për BPGj dhe duke përmirësuar kapacitetet mbikëqyrëse të MFPT për të siguruar që zyrtarët e buxhetit të jenë të aftë të rishikojnë projektbuxhetet nga kjo perspektivë. Për më tepër, objektivi i lidhur me TIK mund të përfshijë kërkesa për analiza gjinore, objektiva, tregues, vlera bazë dhe synime që të integrohen në sistemin e menaxhimit të informacionit të MFP gjatë fazave të planifikimit dhe vlerësimit.

Programi i reformave ekonomike

Edhe pse ka skaduar, PRE për periudhën 2023–2025 përbëhet nga tre shtylla: një program rimëkëmbjeje ekonomike për të zbutur ndikimet e krizave globale të mbivendosura, një politikë fiskale të bazuar në rregulla që synon ruajtjen e stabilitetit dhe një seri reformash strukturore të dizajnuara për të rritur konkurrueshmërinë dhe rritjen gjithëpërfshirëse.¹⁸ Njëzet

¹⁷ Republika e Kosovës, Qeveria, MFPT, [Strategjia për Menaxhimin e Financave Publike të Republikës së Kosovës 2022-2026](#), 2022.

¹⁸ Republika e Kosovës, Qeveria, [Programi i Reformave Ekonomike \(PRE\) 2023-2025](#), 2023.

masat prioritare të reformës, të identifikuar në PRE, vlerësohet se kushtojnë gjithsej 1,544,568,738 euro. Kjo përfshin investime në reformën e tregut të energjisë, arsimin dhe aftësimin profesional, si dhe transformimin digjital të MFP. Nga kjo shumë totale, rreth 985 euromilionë pritet të vijnë nga buxheti kombëtar, ndërsa pjesa tjetër financohet përmes fondeve të instrumentit për ndihmë para anëtarësimit në BE (IPA), kredive të institucioneve financiare ndërkombëtare dhe granteve të donatorëve.

Barazia gjinore është integruar në disa masa reformuese, veçanërisht në ato që adresojnë pjesëmarrjen në tregun e punës dhe mbrojtjen sociale. Qeveria ka planifikuar dhe zbatuar subvencione specifike për punësimin e grave, si mbulimi deri në 50% të pagës mujore bruto për tre muaj (i kufizuar në 264 euro), i ndjekur nga nëntë muaj subvencionim i kontributeve pensionale. Në sektorin e bujqësisë, PRE synon të balancojë pabarazinë aktuale në punësim duke i dhënë prioritet gjinor gjatë vlerësimit të aplikimeve për mbështetje të investimeve strukturore. Reforma e shërbimeve sociale dhe e pensioneve është dizajnuar për të fuqizuar gratë dhe të rinjtë përmes iniciativave të sipërmarrjes sociale, duke marrë parasysh se gratë kanë më shumë gjasa të mbështeten në pensionet bazë për shkak të pjesëmarrjes më të ulët në tregun formal të punës. PRE synonte të rrisë pensionet bazë në 100 euro për kategoritë që më parë merrnin shuma më të ulëta, një masë që përfiton veçanërisht gratë e moshuara. Gjithashtu, PRE thekson se politikat e reja dhe iniciativat legislative do t'i nënshtrohen vlerësimeve të ndikimit në barazinë gjinore (Vlerësimi i ndikimit gjinor - VNGj).

Programi i Kosovës për barazi gjinore

PKBGj 2020-2024 është politika kryesore publike që synon avancimin e barazisë gjinore në të gjithë sektorët.¹⁹ E hartuar dhe e koordinuar nga ABGj nën ZKM, PKBGj është një dokument ligjrisht detyrues që kërkon miratim nga Qeveria dhe raportim vjetor në Kuvend. PKBGj 2020-2024 përfshinte tre shtylla:

- fuqizimi ekonomik dhe mirëqenia sociale: krijimi i mundësive të barabarta për të kontribuar dhe përfituar nga zhvillimi ekonomik, rritja e përfshirjes dhe përmirësimi i mirëqenies sociale.
- zhvillimi njerëzor, rolet dhe marrëdhëniet gjinore: promovimi i barazisë gjinore përmes arsimit cilësor, shëndetit, përfshirjes dhe shfrytëzimit të kapaciteteve njerëzore për të eliminuar pabarazitë dhe stereotipet gjinore.
- të drejtat e grave, qasja në drejtësi dhe siguria: promovimi i realizimit të të drejtave në vendimmarrje, paqe, siguri dhe drejtësi për të garantuar barazinë gjinore.

Objektivat e PKBGj-së synonin të adresonin pabarazitë shumëdimensionale gjinore në pjesëmarrjen ekonomike, përfshirjen sociale, arsimin, përfaqësimin dhe vendimmarrjen. Synimet përfshinin qasjen në financa, integrimin në politikat publike, normat e pjesëmarrjes, mbështetjen për bizneset e grave dhe rolet udhëheqëse.

Vlerësimi i PKBGj-së për periudhën janar 2020–prill 2024 konstatoi se tetë nga 36 treguesit e synuar u arritën (22%). Për shtyllën fuqizimi ekonomik dhe mirëqenia sociale, u përmbushën 30% e 10 synimeve, me 97% të aktiviteteve të planifikuara të zbatuara. Nën shtyllën

¹⁹ Republika e Kosovës, Qeveria, Zyra e Kryeministrit, Agjencia për Barazi Gjinore, [Programi i Kosovës për Barazi Gjinore 2020-2024](#), qershor 2020.

për zhvillimin njerëzor, rolet dhe marrëdhëniet gjinore, u arritën 25% e 12 synimeve dhe 81% e aktiviteteve u zbatuan. Nën shtyllën - Të drejtat e grave, qasja në drejtësi dhe siguria, u realizuan 14% e 14 synimeve dhe 61% e aktiviteteve u përfunduan. Në total, 147 nga 178 aktivitetet e planifikuara u zbatuan (83%) (shih Shtojcën 3). Ky tregues mund të konsiderohet një masë e disa prej ndikimeve të shpenzimeve për barazi gjinore në Kosovë.

PKBGj ka marrë mbështetje financiare nga buxheti i Kosovës dhe donatorët, veçanërisht Qeveria Suedeze, Komisioni Evropian dhe agjencitë e OKB-së. Nga viti 2020 deri në prill 2024, shpenzimet totale arritën në 74 milionë euro, prej të cilave 35 milionë euro u financuan nga shteti. Në vitin 2024, ABGj shpenzoi 354,105.75 euro për aktivitete të fokusura kryesisht në ndërtimin e kapaciteteve, zhvillimin e politikave, rritjen e vetëdijes dhe mbështetjen për fuqizimin ekonomik të grave. Alokimi më i madh iu drejtua skemës së granteve për gratë dhe vajzat nga familjet e personave të zhdukur (249,460 euro), i ndjekur nga subvencionet për OJQ-të që punojnë për barazinë gjinore dhe parandalimin e dhunës ndaj grave (37,580 euro) dhe aktivitetet që lidhen me zhvillimin e kornizës ligjore për BPGj. Disa shpenzime më të vogla u përdorën për trajnime, punëtori, konferenca dhe fushata. Nuk u raportua asnjë shpenzim për iniciimin e hartimit të PKBGj 2025–2035, ndoshta sepse BE mbështeti këtë proces përmes UN Women.

Koncept-dokumenti për buxhetimin e përgjegjshëm gjinor

Koncept-dokumenti për BPGj-në synon të krijojë një kornizë rregullatore që integron qasje të ndjeshme gjinore në të gjitha fazat e menaxhimit të financave publike, përfshirë planifikimin, alokimin, miratimin dhe vlerësimin e burimeve buxhetore.²⁰ Ai u përgatit nën udhëheqjen e ABGj-së në vitin 2022. Dokumenti propozon një sërë instrumentesh ex-ante, ex-post dhe për miratimin e buxhetit, të cilat duhet të përfshihen gjatë gjithë ciklit buxhetor. Instrumentet ex-ante përfshijnë analizën bazë të barazisë gjinore, vlerësimet e ndikimit gjinor, vlerësimet e nevojave gjinore, si dhe integrimin e perspektivës gjinore në alokimin e burimeve dhe kornizat e performancës. Instrumentet ex-post përfshijnë vlerësimet e ndikimit gjinor, auditimet e performancës të ndjeshme gjinore, rishikimet e shpenzimeve të fokusuar në gjini dhe një sistem të dedikuar auditimi për barazinë gjinore. Dokumenti gjithashtu thekson se gjatë fazës së miratimit të buxhetit duhet të mandatohet një deklaratë gjithëpërfshirëse buxhetore gjinore, e cila përfshin deklaratën e përgjithshme të buxhetit, raportin e progresit, analizën e alokimit të burimeve gjinore, vlerësimin e ndikimit gjinor dhe auditimin social të buxhetit.

Koncepti thekson se zbatimi efektiv i BPGj varet nga një kapacitet i fortë institucional dhe nga trajnime të vazhdueshme për zyrtarët publikë. Ai rekomandon kryerjen e analizave të detyrueshme gjinore në të gjitha qarkoret buxhetore dhe krijimin e mekanizmave transparentë të raportimit që integrojnë tregues gjinorë në menaxhimin fiskal. Masat për ndërtimin e kapaciteteve duhet të përfshijnë trajnime të detyrueshme për nëpunësit civilë, zhvillimin e mjeteve metodologjike dhe krijimin e njësisve të ekspertëve në ministri për mbikëqyrjen e zbatimit të BPGj.

Monitorimi dhe llogaridhënia trajtohen si komponentë kyç. Dokumenti propozon një sistem të fuqishëm monitorimi që gjurmon rezultatet e lidhura me gjininë të shpenzimeve publike, siguron disponueshmërinë e të dhënave dhe lehtëson vlerësimet ex-post për identifikimin dhe mbylljen e boshllëqeve gjinore. Ai gjithashtu sugjeron koordinim të ngushtë

²⁰ Republika e Kosovës, Qeveria, Zyra e Kryeministrit, ABGj, [Koncept Dokumenti për Buxhetimin Gjinor të Përgjegjshëm](#), nëntor 2022.

ndërmjet ZKA, Komisionit Rregullativ të Prokurimit Publik, MFPT, ABGj dhe Kuvendit për monitorimin e zbatimit të BPGj.

Për institucionalizimin e BPGj, dokumenti rekomandon reforma të veçanta legislative, duke përfshirë klauzola për barazi gjinore në ligjet vjetore të buxhetit, si në nivel qendror ashtu edhe në nivel lokal, si dhe sigurimin që udhëzimet buxhetore të përmbajnë dispozita specifike gjinore. Ai propozon gjithashtu krijimin e një akti ligjor ose rregulloreje të veçantë që kodifikon BPGj si një element të detyrueshëm të MFP.

Së fundi, dokumenti paraqet një plan zbatimi me faza, duke filluar me miratimin e ndryshimit ligjor të rekomanduar, i ndjekur nga zbatimi i programeve për ndërtimin e kapaciteteve, prezantimi i instrumenteve ex-ante dhe ex-post, si dhe krijimi i një kornize transparente raportimi. Zbatimi i suksesshëm pritet të përmirësojë barazinë gjinore, të promovojë rritjen ekonomike gjithëpërfshirëse dhe të kontribuojë në arritjen e OZHQ-ve, veçanërisht OZHQ 5 për barazinë gjinore.

Duke pasur parasysh mungesën e një qeverie, progresi drejt zbatimit të rekomandimeve të koncept -dokumentit ka qenë i kufizuar.

Qarkoret buxhetore

Deri më 30 prill të çdo viti, MFPT duhet të nxjerrë qarkore buxhetore si udhëzime formale, të cilat përcaktojnë kufijtë sasiorë dhe proceduralë për buxhetin vjetor të secilës organizatë buxhetore. Këto qarkore specifikojnë tavanet e shpenzimeve që rrjedhin nga KASH, përcaktojnë formatin dhe metodologjinë e kërkuar për përgatitjen e kërkesave për ndarje buxhetore dhe vendosin afatet e dorëzimit. Komunitat duhet të dorëzojnë propozimet e tyre buxhetore deri më 30 shtator. Qarkoret gjithashtu përshkruajnë llogaritjen e niveleve të granteve për komunitat, strukturën e kategorive të shpenzimeve dhe detyrimin për të raportuar mbi projektet kapitale në vazhdim dhe mbi buxhetimin e orientuar drejt rezultateve. Që nga viti 2015, qarkoret kanë kërkuar në mënyrë të qartë integrimin e BPGj-së përmes dorëzimit të një “Aneksi për BPGj” nga të gjitha organizatat buxhetore.²¹ Figura 1 ilustron modelin e këtij aneksi, përfshirë vitin 2024.

Figura 1: Modeli i aneksit për BPGj

²¹ RrGK, [Lessons Learned: “Doing” Gender Responsive Budgeting in Kosovo](#) [Mësimet e nxjerra: “Bërja” e buxhetimit të përgjegjshëm gjinor në Kosovë], 2014.

Aneksi 1

Buxhetimi i Përgjegjshëm Gjinor

Tabela 1. Numri i punëtorëve në Organizatën Buxhetore përkatëse
Emri i Institucionit/Ministrisë/Komunës

Viti	Numri total i stafit	Numri total i stafit që janë gra	Numri total i stafit që janë burra	Paga dhe mëditje/Shuma për gra	Paga dhe mëditje/Shuma për burra
2021					
2022					
2023					
Planifikimi për 2024					

Tabela 2. Planifikimi për vitin 2024- Nivelet e pagave në Organizatën Buxhetore
Emri i Institucionit/Ministrisë/Komunës

Niveli i pagave	Numri total i stafit në këtë nivel të pagave	Numri i burrave në këtë nivel	Shuma e shpenzuar për burra në këtë nivel	Numri i grave në këtë nivel	Shuma e shpenzuar për gra në këtë nivel
201-400					
401-600					
600+					

Tabela 3. Numri i përfituesve të subvencioneve apo edhe të shërbimeve ofruara nga organizata buxhetore të drejtorive përkatëse (ku është e aplikueshme)

[Emri i Institucionit/Ministrisë/Komunës: Emri i Shërbimit/Subvencionit].

Viti	Buxheti total i shërbimit/subvencionit të caktuar	Numri total i përfituesve	Numri i përfituesve gra	Numri i përfituesve burra	Buxheti për gra	Buxheti për burra
2021						
2022						
2023						
Planifikimi për 2024						

Ky shabllon ofron informacion të dobishëm që përndryshe nuk do të ishte në dispozicion për shkak se në Kosovë përdoret buxhetimi sipas zërave. Megjithatë, ai nuk kërkon analizë gjinore, objektiva për të adresuar pabarazitë e identifikuar përmes analizës gjinore ose tregues për matjen e ndryshimeve. Kjo përbën një mundësi të humbur për të treguar më qartë se si shpenzimet do të kontribuojnë në realizimin e objektivave. Kërkesa që organizatat buxhetore të dorëzojnë këtë informacion do të ishte në përputhje me praktikën më të mirë në BPGj, duke përfshirë dokumentacionin e propozuar të buxhetit të përgjegjshëm gjinor, të kërkuar nga Korniza suplementare për vlerësimin e menaxhimit të përgjegjshëm gjinor të financave publike ([PEFA GRPFM](#)) dhe deklaratën buxhetore gjinore të kërkuar nga udhëzimet për treguesin 5.c.1

të objektivave për zhvillim të qëndrueshëm të Kombeve të Bashkuara.²² Raporti PEFA GRPFM i vitit 2022 për Kosovën konstatoi se asnjë organizatë qendrore ose lokale buxhetore nuk ka kryer analizë të ndikimit gjinor gjatë procesit vjetor të buxhetimit.²³ Ndërkohë, 34 nga 38 organizata lokale buxhetore (89 %) dhe 31 nga 50 organizata qendrore buxhetore (62 %) dorëzuan aneksin e tyre të BPGj-së të MFPT.²⁴ Megjithatë, pak organizata buxhetore e publikuan aneksin, gjë që dëmton transparencën dhe llogaridhënien, pasi bëhet e vështirë për qytetarët dhe OJQ-të të monitorojnë alokimet e planifikuara. Publikimi i tyre do të ishte në përputhje me praktikatat ndërkombëtare më të mira të parashikuara nga udhëzuesi për treguesin 5.c.1 të OZHQ dhe PEFA GRPFM.

Alokimet dhe shpenzimet për barazinë gjinore

Ky seksion paraqet gjetjet, duke u bazuar në të dhënat e disponueshme mbi alokimet, shpenzimet dhe mospërputhjet lidhur me financimin e Qeverisë për çështje të lidhura me gjininë. Në përgjithësi, monitorimi i alokimeve dhe shpenzimeve buxhetore drejt barazisë gjinore mbetet sfidues për shkak të përdorimit të buxhetimit sipas zërave në Kosovë, gjë që e vështirëson gjurmimin e mënyrës se si resurset kontribuojnë në rezultatet e barazisë gjinore. Edhe pse disa ligje, strategji dhe programe përmbajnë objektiva, aktivitete dhe alokime buxhetore drejt barazisë gjinore, ato janë të shpërndara dhe të integruara brenda linjave më të gjera buxhetore. Analiza u kufizua gjithashtu nga mungesa e të dhënave gjithëpërfshirëse që janë publikisht të disponueshme në Kosovë.²⁵ Një analizë e plotë do të kërkonte hulumtim shtesë të konsiderueshëm. Prandaj, ky seksion fokusohet në alokimet e qarta drejt barazisë gjinore në Ligjin për Buxhetin 2024 dhe në Programin e Kosovës për Barazi Gjinore, si strategjia kryesore për avancimin e barazisë gjinore. Ndërsa raportohet se 16 komuna kanë zhvilluar plane lokale të veprimit për barazi gjinore, ishte përtej fushëveprimit të këtij hulumtimi të analizohej mënyra se si të gjitha komunat kanë alokuar dhe shpenzuar fonde për këto plane, nëse informacioni nuk ishte përfshirë drejtpërdrejt në Buxhetin 2024. Megjithatë Rrjeti i Grave të Kosovës (RrGK) dërgoi kërkesa për të dhëna, vetëm nëntë komuna ofruan informacion mbi alokimet dhe shpenzimet, duke penguar një analizë të plotë (shih Shtojcën I).

Ligji për Buxhetin 2024.²⁶ nuk u shoqërua me një deklaratë buxhetore gjinore ose me anekse të disponueshme publikisht, gjë që kufizoi mundësinë e mbikëqyrjes nga qytetarët.²⁷ Broshura informuese për qytetarët për vitin 2024, e cila synon të informojë publikun mbi

²² Divizioni i Statistikave i OKB-së, treguesi 5.c.1 i OZHQ, [SDG indicator metadata](#). Kosova është zotuar për zbatimin e OZHQ-ve (Republika e Kosovës, Kuvendi, [Rezoluta për miratimin e objektivave të zhvillimit të qëndrueshëm](#), 2018).

²³ PEFA, [2022 Kosovo Public Expenditure and Financial Accountability \(PEFA\) report](#) [Raporti i vitit 2022 për vlerësimin e shpenzimeve publike dhe llogaridhënies financiare (PEFA) për Kosovën], 2022.

²⁴ RrGK, kërkesë për të dhëna drejtuar MFPT.

²⁵ Në përgjithësi, transparenca buxhetore mbetet e kufizuar. Në pilot-projektin e Open Budget Partnership për vitin 2023, Kosova arriti një rezultat prej 50/100 për transparencë dhe vetëm 9/100 për pjesëmarrje publike (Grupi për Studime Juridike dhe Politike, *Fondet Publike, Shëndeti Publik: Rishikimi i Transparencës së Buxhetit të Shëndetësisë në Kosovë*), 2025.

²⁶ Kuvendi i Republikës së Kosovës, [Ligji Nr. 08/L-260 për Ndarjet Buxhetore për Buxhetin e Republikës së Kosovës për Vitin 2024](#), 2023.

²⁷ RrGK, [Drejt një buxheti për qytetarët: Rishikim gjinor i buxhetit të Kosovës 2024](#), mars 2024.

buxhetin e këtij viti, pothuajse nuk trajtoi objektivat e barazisë gjinore; masat e vetme të përmendura lidhen me përfitimet e lehonisë dhe shtesat për fëmijë.²⁸ Për më tepër, broshura u publikua në qershor 2024, shtatë muaj pas miratimit të buxhetit, ndërkohë që një dokument i tillë duhet të vihet në dispozicion para miratimit, për të mundësuar informim të drejtëkohshëm të publikut dhe pjesëmarrje kuptimplotë në procesin buxhetor. Pa një Deklaratë të qartë Buxhetore Gjinore, qytetarët nuk mund të vlerësojnë nëse buxheti bazohet në analiza gjinore ose se si synon të kontribuojë në avancimin e barazisë gjinore.

Vetëm disa linja buxhetore mund të identifikohen qartë si të lidhura me avancimin e barazisë gjinore (shih Tabelën 1). Këto lidhen me ABGJ, alokimet komunale për çështje gjinore dhe subvencionet e Ministrisë së Drejtësisë për strehimore. Programet dhe aktivitetet e tjera që kontribuojnë në barazinë gjinore nuk janë lehtësisht të identifikueshme në Ligjin për Buxhetin, pasi buxheti nuk prezantohet në mënyrë që të lidhet shpenzimi me objektivat ose përfituesit e lidhur me gjininë.

Raporti vjetor financiar 2024 i buxhetit të Republikës së Kosovës paraqet buxhetin sipas planifikimit në ligjin për buxhetin, si dhe shpenzimet e ekzekutuara. Ai përshkruan një buxhet fiskalisht konservativ, por me orientim social, duke përdorur në masë të konsiderueshme subvencione dhe transfere për të mbështetur familjet, skemat sociale dhe rimëkëmbjen ekonomike. Në nivel makro, të hyrat totale buxhetore në vitin 2024 arritën rreth 3.08 miliardë euro, pak mbi planin fillestar prej 3.02 miliardë eurosh, ndërsa shpenzimet buxhetore u rritën nga 3.2 miliardë euro të planifikuara në 3.3 miliardë euro. Në nivel qendror, buxheti i alokuar ishte 2.51 miliardë euro dhe buxheti i zbatuar arriti në 2.53 miliardë euro. Në nivel lokal, u alokuan 742.9 milionë euro dhe u shpenzuan 843.8 milionë euro (shih Shtojcën 2). Raporti paraqet shifra të detajuara për institucionet, të ndara sipas kategorive ekonomike si paga dhe mëditje, mallra dhe shërbime, subvencione dhe transfere, si dhe shpenzime kapitale. Ai nuk raporton sipas programeve ose aktiviteteve. Asnjë nga deklaratat kryesore ose tabelat e bashkëngjitura nuk ndan shumatat e planifikuara ose të ekzekutuara sipas grave dhe burrave ose vajzave dhe djemve. Gjinia si kategori e buxhetimit dhe raportimit është pothuajse e padukshme.

Tabela 1 përmbledh alokimet dhe shpenzimet buxhetore të lidhura me avancimin e barazisë gjinore, siç janë identifikuar nga RrGK në ligjin për buxhetin ose siç janë ofruar nga institucionet përkatëse pas kërkesave për të dhëna. Vlen të theksohet se jo të gjitha të dhënat ishin të disponueshme në dokumentet buxhetore, raportet e shpenzimeve ose përgjigjet ndaj kërkesave për të dhëna; prandaj, tabela paraqet vetëm informacion të pjesëshëm mbi alokimet dhe shpenzimet. Për më tepër, disa institucione nuk ishin në gjendje të ndanin të dhënat sipas gjinisë dhe kanë ofruar vetëm shumatat totale. Linjat që kontribuojnë drejtpërdrejt në barazinë gjinore janë të shënuara me ngjyrë vjollcë, ndërsa linjat e tjera kontribuojnë vetëm pjesërisht në barazinë gjinore, duke treguar mbivlerësime të mundshme në shpenzimet e dedikuara për barazinë gjinore.

Tabela 1. Alokimet dhe shpenzimet buxhetore të lidhura me barazinë gjinore në buxhetin e vitit 2024 (në euro)²⁹

²⁸ MFPT, Informatori për qytetarë, [Broshurë informuese për qytetarët 2024](#), qershor 2024.

²⁹ Të gjitha shumatat janë rrumbullakosur në euro më të afërt për qartësi dhe lehtësi leximi.

Linja buxhetore	Institucioni përgjegjës	Kategoria e shpenzimeve	Alokimi	Shpenzimet	Diferenca
Agjencia për Barazi Gjinore (ABGj)	ABGJ-ZKM	Pagat dhe mëditjet	180,384	164,809	15,575
ABGj	ABGJ-ZKM	Mallrat dhe shërbimet	164,000	129,943.43	34,056.57
ABGj	ABGJ-ZKM	Shërbimet komunale	2,550	561.64	1,988.36
ABGj	ABGJ-ZKM	Subvencionet dhe transferet	40,000	32,000.00	8,000.00
ABGj	ABGJ-ZKM	Investimet kapitale	0	Nuk figuron në raportin financiar vjetor	
Çështjet e barazisë gjinore	Komunat	Gjithsej ³⁰	291,137	Nuk figuron në raportin financiar vjetor	
Shpenzimet bazë për strehimoret	MD	Subvencionet dhe transferet	1,500,000	287,000	1,213,000
Pagesat për shtesat për gratë pas lindjes së fëmijës	MFPT	Subvencionet dhe transferet	95,000,000	39,999,382	55,000,618
Zbatimi i ligjit nr. 04/I-054 për viktimat e dhunës seksuale gjatë luftës së fundit	MFPT	Mallrat dhe shërbimet	78,580	Nuk figuron në raportin financiar vjetor	
Zbatimi i ligjit nr. 04/I-054 për viktimat e dhunës seksuale gjatë luftës së fundit	MFPT	Subvencionet dhe transferet	4,200,000	Nuk figuron në raportin financiar vjetor	
Pensionet për personat me aftësi të kufizuara	MFPT	Subvencionet dhe transferet	29,441,319	47,686	
Pensionet për personat me aftësi të kufizuara	MFPT	Alokuar ³¹		2,038,421	
Kompenzimi për të verbrit	MFPT	Subvencionet dhe transferet	5,289,240	5,580	
Kompenzimi për të verbrit		Alokuar		154,635	
Pensioni familjar	MFPT	Subvencionet dhe transferet	4,133,894	It is not included in the annual financial report	
Pensioni familjar		Alokuar		76,258	
Personat paraplegjikë dhe tetraplegjikë	MFPT	Subvencionet dhe transferet	11,517,841	It is not included in the annual financial report	
Personat paraplegjikë dhe tetraplegjikë		Alokuar		260,948	
Skema për fëmijët me aftësi të kufizuara, mosha 1-18 vjeç	MFPT	Subvencionet dhe transferet	4,353,850	79,900	
Departamenti i Skemave Sociale	MFPT	Pagat dhe mëditjet	148,054	Nuk figuron në raportin financiar vjetor	
Departamenti i Skemave Sociale	MFPT	Mallrat dhe shërbimet	1,261,099	Nuk figuron në raportin financiar vjetor	

³⁰ Shih Shtojcën I.

³¹ Kjo dhe përfitime të tjera u ri-alokuan në linja të tjera buxhetore, dhe fjala “alokuar” u përdor për ta treguar këtë në këtë linjë, si dhe në disa linja të tjera të përmendura më sipër.

Linja buxhetore	Institucioni përgjegjës	Kategoria e shpenzimeve	Alokimi	Shpenzimet	Diferenca
Departamenti i Skemave Sociale	MFPT	Subvencionet dhe transferet	49,500,000	Nuk figuron në raportin financiar vjetor	
Shtesat për fëmijët 0-2 vjeç	MFPT	Subvencionet dhe transferet		30,229	
Shtesat për fëmijët 2-16 vjeç	MFPT	Subvencionet dhe transferet		50,557	
Gratë e punësuar në institucionet publike	MFPT	Subvencionet dhe transferet		2,332	
Mamitë e punësuar	MFPT	Subvencionet dhe transferet		3,533	
Nënat e papuna	MFPT	Subvencionet dhe transferet		15,132	
Trajtimi për viktimat e dhunës seksuale gjatë luftës së fundit	Fondi i Sigurimeve Shëndetësore	0	0	Nuk figuron në raportin financiar vjetor	
Trajnim gjatë punës	MFPT			2,040	
Punë publike	MFPT			3,168	
Skema për subvencionimin e pagave	MFPT			2,691,190	
Skemë për fillimin e vetëpunësimit	MFPT			87,136	
Skemë e praktikës në vetëpunësim	MFPT			1,200,723	
Nënat e reja (përfitim materniteti)	MFPT			2,337,122	
Ndërtimi i banesave	Ministria për Komunitete dhe Kthim (MKK)			1,252,230	
Rinovimi i shtëpive për komunitetet	MKK			81,374	
Mobilje dhe pajisje të bardha shtëpiake (totali)	MKK			356,477	
Mbështetje për zhvillim ekonomik	MKK			184,958	
Mbështetje për bujqësi	MKK			569,699	
Subvencione për OJQ-të	MKK			199,970	
Start-Up – Studentet (2 përfituese gra)	Ministria e Zhvillimit Rajonal (MZhR)			7,953	
Start-Up (40 përfituese gra)	MRD			190,199	
Lot 1 – Bizneset ekzistuese (23 përfituese gra)	MZhR			308,756	
Lot 2 – Bizneset ekzistuese (5 përfitues gra)	MZhR			150,000	

Linja buxhetore	Institucioni përgjegjës	Kategoria e shpenzimeve	Alokimi	Shpenzimet	Diferenca
Mbështetje financiare për përfitueset gra (70 biznese)	MZhR			656,908	
Aktivitetet PKBGj për 2024	PKBGj			354,106	
Gjithsej			206,921,564	51,848,107	155,073,457

Siç tregohet në Tabelën I, raporti vjetor financiar nuk pasqyron ekzekutimin e shumicës së alokimeve, duke e bërë të pamundur vlerësimin e nivelit real të shpenzimeve. Shpenzimet që lidhen me shërbimet për të mbijetuarit e dhunës seksuale nuk raportohen qartë. Disa alokime që lidhen drejtpërdrejt ose tërthorazi me barazinë gjinore janë përfshirë brenda skemave të mbrojtjes sociale të menaxhuara nga MFPT. Këto përfshijnë shtesat e lehonisë dhe për fëmijët, pensionet për personat me aftësi të kufizuara, kompensimin për të verbrit, pensionet familjare, mbështetjen për personat paraplegjikë dhe tetraplegjikë, si dhe skemat për fëmijët me aftësi të kufizuara. Ndërsa këto programe janë thelbësore për mirëqenien e grave, fëmijëve dhe grupeve të tjera të cenueshme, të dhënat tregojnë boshllëqe të konsiderueshme midis shpenzimeve të planifikuara dhe atyre të ekzekutuara, përfshirë raste ku ekzekutimi është shumë i ulët ose nuk raportohet fare. Për më tepër, struktura e buxhetit nuk lejon identifikimin e përfituesve sipas gjinisë, as vlerësimin se si këto alokime adresojnë nevoja specifike gjinore. Si rezultat, edhe pse këto skema mund të përfitojnë gra dhe burra, kontributi i tyre në barazinë gjinore mbetet i paqartë në raportimin buxhetor. Kjo nënvizon nevojën për një dokumentacion buxhetor të përgjegjshëm gjinor, i cili lidh alokimet financiare me objektivat e politikave, grupet e synuara dhe rezultatet e matshme.

Raporti i PKBGj-së paraqet informacion mbi shpenzimet dhe ndikimet e aktiviteteve të zbatuara në vitin 2024 për avancimin e barazisë gjinore (Tabela 2). Një shumë totale prej 354,105.75 eurosh u shpenzua për aktivitete të ndryshme, përfshirë monitorimin dhe vlerësimin e PKBGj, hartimin e PKBGj të ri për periudhën 2025–2035 dhe Planit të tij të Veprimit, ndërtimin e kapaciteteve për ZBGj, zhvillimin e kornizës ligjore për BPGj, mbështetjen për organizatat joqeveritare që punojnë për barazinë gjinore dhe parandalimin e dhunës me bazë gjinore, fuqizimin ekonomik të grave nga familjet e personave të zhdukur, fushata për rritjen e vetëdijes, konferenca, trajnime dhe aktivitete promovuese. Këto shpenzime pasqyrojnë përpjekjet institucionale për të forcuar qeverisjen, llogaridhënien, pjesëmarrjen e grave në vendimmarrje dhe zbatimin e angazhimeve kombëtare dhe ndërkombëtare për barazi gjinore.

Tabela 2. Zbatimi i buxhetit për aktivitetet e ABGj në vitin 2024 në euro

Përshkrimi	Shpenzimet
Raporti i monitorimit për vlerësimin e PKBGj për vitin 2022	1,001.90
Raporti i monitorimit për vlerësimin e PKBGj 2020–2024	1,804.04
Punëtori – Takimi i zyrtarëve për barazi gjinore për raportimin përfundimtar dhe monitorimin e PKBGj	676.50
Punëtori në bashkëpunim me UN Women për fillimin e hartimit të PKBGj të ri	391.50
Fillimi i hartimit të PKBGj2025–2035 dhe Planit të Veprimit 2025–2028 (grupi punues u formua dhe metodologjia u përgatit dhe u prezantua)	–

Subvencione për katër OJQ që punojnë në fushën e barazisë gjinore dhe parandalimit e dhunës ndaj grave (përfshirë gratë rome, ashkalike dhe egjiptiane, nënat beqare dhe gratë e moshuara)	37,580.00
Skema e granteve që mbështet 64 gra dhe vajza nga familjet e personave të zhdukur përmes pakos së rimëkëmbjes ekonomike (kryesisht pajisje bujqësore)	249,460.00
Mbështetje për themelimin e Rrjetit të Grave në Administratën Publike (4 punëtori, 121 pjesëmarrës)	1,398.00
Punëtori për hartimin e kornizës ligjore për BPGJ-në (me MFPT dhe UN Women)	11,660.88
Pesë sesione informuese me Policinë e Kosovës mbi Konventën e Stambollit dhe ligjin për mbrojtjen nga dhuna në familje	3,541.98
Grupi punues për përditësimin e procedurave standarde të veprimit për mbrojtjen nga dhuna në familje dhe dhuna me bazë gjinore	7,206.60
Konferenca “Mbyllja e hendekut gjinor” me Universitetin e Prishtinës	3,727.00
Shkolla verore mbi barazinë gjinore, ekonominë dhe politikën (me NDI – [Instituti Kombëtar Demokratik])	606.25
Trajnim mbi kornizën kundër korrupsionit dhe konfliktin e interesit	1,102.10
Trajnim mbi integritetin për stafin e ABGj-së	1,214.00
Trajnim për ZBGJ-të komunale mbi “Promovimin e barazisë gjinore përmes TI të avancuar”	7,084.00
Konferenca për Ditën Ndërkombëtare të Grave – “Së bashku për barazinë”	1,338.00
Takim konsultativ në nivel të lartë për shënimin e përvjetorit të Platformës së Pekinit dhe RKBKS 1325	2,367.60
Aktivitet për muajin e ndërgjegjësimit për kancerin e gjirit	1,587.70
Fushata “16 Ditë Aktivizmi” – materiale ndërgjegjësuese dhe ndriçimi i ndërtesave qeveritare	3,768.70
Produksion dhe transmetim i pesë videove promovuese mbi barazinë gjinore	15,191.50
Punëtori me Komitetin e Rrjetit të Grave për fuqizimin e grave në pozitë të vendimmarrjes	1,397.50
Gjithsej	354,105.75

Përveç raportit të PKBGj, nuk ka analiza të tjera të ndikimit që të shqyrtojnë se si shpenzimet kanë kontribuar në avancimin e barazisë gjinore në raportet vjetore financiare. Kjo mungesë transparence dhe raportimi në nivel programi e vështirëson vlerësimin se si fondet publike kanë ndikuar në promovimin e barazisë gjinore.

Jo të gjitha komunat publikojnë të dhëna mbi shpenzimet që lidhen me shërbimet për barazi gjinore. Raportet e shpenzimeve buxhetore nuk janë gjithmonë të disponueshme publikisht, duke kufizuar transparencën dhe mundësinë për mbikëqyrje publike. Vetëm 37% e komunave kanë publikuar aneksin e kërkuar për BPGj në faqet e tyre të internetit, ndërsa 71% kanë publikuar raportet e shpenzimeve buxhetore për vitin 2024.³² Aneksët komunalë për BPGj shpesh janë të paplotë ose përmbajnë gabime.³³ Për këto arsye, alokimet dhe shpenzimet nuk mund të analizoheshin për komunat që nuk iu përgjigjën kërkesave për informacion të RrGK-së. Informacioni i disponueshëm mbi shpenzimet që njihen si të orientuara drejt barazisë gjinore, siç raportohet nga komunat të RrGK, është përmbledhur në Tabelën 3.³⁴

Tabela 3. Shpenzimet komunale të identifikuara për qëllime të arritjes së barazisë gjinore në vitin 2024 në euro

Komuna	Përshkrimi	Shpenzimet
Prishtinë	Pagesa direkte për gratë fermere (Drejtoria e Bujqësisë)	22,715

³² RrGK, analiza e faqeve të internetit të komunave, 21 korrik 2025.

³³ Instituti GAP, [Buxheti i përgjigjshëm gjinor në komuna](#), 2023.

³⁴ Të gjitha shumat janë rrumbullakosur në euro më të afërt për qartësi dhe lehtësi leximi.

Prishtinë	Pagesa direkte për viktimat e dhunës në familje (Drejtoria e Mirëqenies Sociale)	217,600
Prishtinë	Aktivitete të ZBGJ-së sipas Planit të Veprimit për Barazi Gjinore	20,000
Fushë Kosovë	Paga dhe mëditje	15,611
Fushë Kosovë	Mallra dhe shërbime	1,695
Fushë Kosovë	Subvencione dhe transfere	5,000
Drenas	Subvencione për biznese start-up – 9 biznese të mbështetura (5 të udhëhequra nga gra, 4 të udhëhequra nga burra) ³⁵	12,366
Drenas	Mbështetje për fermerët: 231 përfitues (187 burra, 44 gra) – Drejtoria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural ³⁶	123,179
Dragash	Mbështetje për strehimoren e Prizrenit	1,700
Dragash	Mbështetje për 18 gra fermere	5,234
Dragash	Bursa për 72 vajza	32,277
Suharekë	Kulturë, rini dhe sport	39,700
Suharekë	Bursa	136,200
Suharekë	Bonus banimi	16,657
Suharekë	Mbështetje për strehimore	4,000
Suharekë	Trajtim mjekësor rehabilitues	6,804
Suharekë	Subvencion për lindje	750
Suharekë	Bujqësi	55,099
Suharekë	Ndihmë financiare emergjente	47,012
Vushtrri	Çështje të barazisë gjinore – Pronësi	250
Vushtrri	Çështje të barazisë gjinore – Dhuna në familje	340
Vushtrri	Shëndetësi – Qira	2,400
Vushtrri	Çështje të barazisë gjinore – Siguria	150
Vushtrri	Arsim – Bursa	42
Vushtrri	Kulturë – Sport	12
Vushtrri	Zhvillim ekonomik – Subvencione për gra	76,521
Skenderaj	Arsim – Bursa për studentet (110 × 500 €)	55,000
Gjithsej		898,314

Të dhënat buxhetore komunale tregojnë se disa komuna kanë alokuar fonde për programe që kontribuojnë në barazinë gjinore në vitin 2024. Fusha dhe qëllimi i këtyre shpenzimeve ndryshonin ndjeshëm. Alokimet më të mëdha të raportuara ishin në Prishtinë, e cila financoi pagesa direkte për gratë fermere (22,715 euro), mbështeti viktimat e dhunës në familje (217,600 euro) dhe zbatoi aktivitete në kuadër të Planit të Veprimit për Barazi Gjinore (20,000 euro). Investime të konsiderueshme u bënë gjithashtu nga Suhareka, kryesisht përmes bursave (136,200 euro), mbështetjes për bujqësinë (55,099 euro), ndihmës emergjente financiare (47,012 euro), kulturës, rinisë dhe sportit (39,700 euro) si dhe për strehim dhe masa sociale. Skenderaj ofroi subvencione të konsiderueshme për zhvillim ekonomik, si për gratë (76,521 euro) ashtu edhe për burrat (80,650 euro), dhe financoi bursa për studentë (55,000 euro). Në Drenas, subvencionet për bizneset start-up mbështetën ndërmarrje të udhëhequra nga gra dhe burra, ndërsa subvencionet bujqësore arritën te një numër i madh përfituesish, kryesisht burra. Dragashi alokoi fonde për bursa për vajza, mbështetje për gratë fermere dhe

³⁵ Vlen të theksohet se nga këto fonde përfituan si gratë ashtu edhe burrat, por komuna nuk ka ofruar të dhëna të ndara sipas gjinisë; për këtë arsye, kjo shifër mund të jetë më e madhe se shumica reale e shpenzuar.

³⁶ E njëjta gjë vlen; komuna nuk ka ofruar të dhëna të ndara sipas gjinisë.

një kontribut për strehimoren në Prizren. Fushë Kosova raportoi shpenzime në kategoritë paga dhe mëditje, mallra dhe shërbime, si dhe subvencione dhe transfere. Vushtrria raportoi për alokime shumë të vogla për aktivitete të lidhura me barazinë gjinore, duke treguar një prioritet financiar të kufizuar. Në përgjithësi, të dhënat ilustronë përpjekjet komunale, veçanërisht në mbrojtjen sociale, bujqësi dhe arsim. Ato gjithashtu tregojnë nivele të pabarabarta të financimit, synim të kufizuar të drejtpërdrejtë ndaj grave në disa masa ekonomike dhe nevojën për planifikim buxhetor më sistematik dhe të përgjegjshëm gjinor nëpër komuna.

Konkluzion

Fakti që Kosova përdor buxhetimin sipas zërave, dhe jo buxhetimin programor ose të bazuar në rezultate, e vështirëson lidhjen e qartë të buxheteve dhe shpenzimeve me objektivat e Qeverisë për barazi gjinore. KASH dhe aneksi aktual për BPGj, i kërkuar nga qarkoret buxhetore, mund të përmirësohen për të përfshirë më shumë analizë gjinore, objektiva, tregues, vlera bazë dhe synime, duke krijuar një “Deklaratë buxhetore gjinore” që lidhet në mënyrë të qartë me shpenzimet e planifikuara dhe objektivat e barazisë gjinore. Udhëzuesit ndërkombëtarë, si treguesi 5.c.I i OZHQ dhe PEFA GRPFM, kërkojnë qartë nga qeveritë që të zbatojnë BPGj-në dhe të publikojnë deklarata dhe anekse të tilla, në mënyrë që qytetarët të mund të ndjekin mënyrën se si alokohen fondet, sa shpenzohet për objektivat e barazisë gjinore dhe cilat rezultate priten. Integrimi i BPGj-së dhe publikimi i një deklarate buxhetore gjinore në sistemin e financave publike, përmes ndryshimeve në ligjin për menaxhimin e financave publike, qarkoret buxhetore dhe KASH, mund të institucionalizojë analizën gjinore përgjatë gjithë ciklit buxhetor dhe të lehtësojë monitorimin e rregullt të mënyrës se si shpenzimet kontribuojnë në përmbushjen e zotimeve për barazi gjinore.

Ndërkohë, raportet e shpenzimeve publikohen rrallë, gjë që e bën të vështirë vlerësimin se në çfarë mase alokimet janë shpenzuar sipas planifikimit. Po ashtu, informacioni mbi ndikimet e shpenzimeve nuk publikohet, përveç raportit të vlerësimit të PKBGj. Transparenca e pamjaftueshme e vështirëson monitorimin nga qytetarët, vlerësimin e ndikimeve dhe mbajtjen e institucioneve përgjegjëse, si në përgjithësi ashtu edhe specifikisht për shpenzimet që synojnë avancimin e barazisë gjinore. Monitorimi i shpenzimeve është thelbësor për transparencë, llogaridhënie dhe përdorim efikas të burimeve publike të kufizuara, veçanërisht kur qeveritë operojnë me buxhetim sipas zërave, që e errëson mënyrën se si shpenzimet kontribuojnë në arritjen e objektivave strategjikë. Në Kosovë, përdorimi i buxheteve sipas zërave dhe strategjitë që nuk përcaktojnë alokime të qarta e bëjnë shumë të vështirë analizimin e mënyrës se si shpenzimet mbështesin objektivat e barazisë gjinore. Pa monitorim sistematik, qeveritë rrezikojnë të nëninvestojnë në sektorë që ndikojnë në mënyrë disproporcionale te gratë, si kujdesi, transporti rural, bujqësia dhe shërbimet sociale.

Rekomandimet

Rekomandimet synojnë të institucionalizojnë BPGJ në përputhje me LBGJ dhe praktikat më të mira ndërkombëtare, përfshirë [PEFA GRPFM](#) dhe udhëzuesin e OKB-së për [OZHQ 5.c.I](#).

Për Ministrinë e Financave

- o Të sigurohet institucionalizimi i BPGj-së në ndryshimet e ardhshme të ligjit për menaxhimin e financave publike. Të përfshihen në sistemet digjitale të menaxhimit financiar kërkesat për të ofruar analizë gjinore, objektiva, tregues, vlera bazë dhe synime për avancimin e barazisë gjinore, të lidhura me shpenzimet buxhetore të planifikuara.
- o Të ndryshohet Ligji për Financimin e Pushtetit Lokal që të kërkojë BPGj-në në hartimin, alokimin, zbatimin dhe monitorimin e të gjitha granteve komunale, duke obliguar komunat të aplikojnë analizë gjinore gjatë planifikimit të përdorimit të fondeve të granteve, të përdorin të dhëna të ndara sipas gjinisë dhe tregues të barazisë gjinore, si dhe të vlerësojnë ndikimin e diferencuar të shpenzimeve të gratë, burrat, vajzat dhe djemtë. Përdorimi i granteve të bazuara në performancë duhet të kushtëzohet me përgatitjen dhe publikimin e deklaratave buxhetore gjinore ose anekseve për BPGj në nivel komunal, si dhe me raportimin e rezultateve të matshme për reduktimin e pabarazive gjinore. Ligji duhet gjithashtu të kërkojë që shpenzimet komunale, të financuara përmes granteve specifike, të përfshijnë alokime të dedikuara për shërbime që adresojnë boshllëqet gjinore të identifikuara, si kujdesi për fëmijët, shërbimet sociale dhe të kujdesit, parandalimi i dhunës me bazë gjinore dhe fuqizimi ekonomik i grave. Ligji duhet të parashikojë monitorim të detyrueshëm dhe raportim të rregullt publik në nivel komunal, në përputhje me LBGj.
- o Të ndryshohet ligji për prokurimin publik për të kërkuar analizë gjinore si pjesë e analizës së situatës dhe për të përcaktuar dhe parashikuar më qartë masa afirmative drejt avancimit të barazisë gjinore si pjesë e proceseve të prokurimit publik.
- o Të sigurohet që SMFP e ardhshme të përfshijnë objektiva të qarta drejt institucionalizimit të BPGj-së në menaxhimin e financave publike në përputhje me ligjin për barazinë gjinore. Kjo duhet të përfshijë përmirësimin e udhëzimeve për institucionalizimin e BPGj-së në menaxhimin financiar, avancimin e kapaciteteve të zyrtarëve të financave publike për BPGj dhe forcimin e kapaciteteve mbikëqyrëse brenda Ministrisë së Financave për të siguruar që zyrtarët e buxhetit të mund të rishikojnë projektbuxhetet nga kjo perspektivë. Të sigurohet gjithashtu që objektivat e lidhura me TIK të përfshijnë kërkesa për analizë gjinore, objektiva, tregues, vlera bazë dhe synime, të jenë të integruara në sistemin e menaxhimit të informacionit të menaxhimit financiar në fazat e planifikimit dhe vlerësimit.
- o Të zgjerohen modelet ekzistuese për BPGj-në në qarkoret buxhetore për të kërkuar analizë gjinore, objektiva, tregues, vlera bazë dhe synime. Të kërkohet publikimi i anekseve për barazi gjinore nga të gjitha organizatat buxhetore, në mënyrë që të përmirësohet transparenca dhe llogaridhënia.
- o Të publikohet deklarata buxhetore gjinore që shoqëron çdo ligj për buxhetin, duke sqaruar mënyrën se si shpenzimet do të kontribuojnë në barazinë gjinor.

Për komunat

- o Të alokohet financim adekuat dhe i qëndrueshëm për avancimin e barazisë gjinore në nivel komunal, duke siguruar fonde në linjën e dedikuar buxhetore për çështje gjinore, përfshirë një pagë të caktuar për ZBGj dhe burime të mjaftueshme operative për përmbushjen efektive të mandatit të tyre ligjor. Kjo duhet të mbulojë kostot për analizën gjinore, monitorimin dhe raportimin, ndërtimin e kapaciteteve, koordinimin me drejtoritë komunale,

aktivitetet e vetëdijesimit publik dhe angazhimin e palëve të interesit, në përputhje me LBGj dhe Rregulloren për rolet dhe përgjegjësitë e ZBGj. Gjithashtu, duhet të sigurohet financim për zbatimin, monitorimin dhe vlerësimin e planeve komunale të veprimit për barazi gjinore.

- o Të sigurohet përfshirja sistematike e ZBGj-ve duke kërkuar konsultimin e tyre formal dhe kontributin me shkrim gjatë hartimit, zbatimit, monitorimit dhe raportimit të strategjive sektoriale, programeve, planeve vjetore dhe buxheteve në të gjitha departamentet komunale.

Shtojca I. Buxhetet komunale për barazi gjinore (Linja buxhetore për çështje gjinore)

Kjo shtojcë paraqet alokimet buxhetore komunale për barazi gjinore, në kuadër të linjës buxhetore për çështje gjinore, siç janë planifikuar nga komunat për vitin 2024.

Tablela 4. Buxhetet komunale për barazi gjinore (Linja buxhetore për çështje gjinore)

Komuna	Linja buxhetore për çështje gjinore
Deçan	
Dragash	11,200 €
Ferizaj	
Fushë Kosovë	24,911 €
Gjakovë	
Gjilan	
Drenas	
Graçanicë	11,760 €
Han i Elezit	
Istog	29,535 €
Junik	
Kaçanik	12,248 €
Kamenicë	15,501 €
Klinë	13,393 €
Klllokot	
Leposaviq	
Lipjan	
Malishevë	19,621 €
Mamushë	
Mitrovicë e Veriut	
Mitrovicë	44,380 €
Novobërdë	13,600 €
Obiliq	
Partesh	7,000 €
Pejë	13,037 €
Podujevë	
Prishtinë	
Prizren	
Rahovec	8,964 €
Ranillug	10,769 €
Shtërpçë	
Shtime	
Skenderaj	36,880 €
Suharekë	
Viti	
Vushtrri	18,338 €
Zubin Potok	
Zveçan	
Gjithsej	291,137 €

Shtojca 2. Alokimi dhe zbatimi i buxhetit sipas organizatave buxhetore

Kjo shtojcë përmban tabela për organizatat buxhetore në nivel qendror dhe lokal, duke paraqitur shumat e alokuara dhe shpenzimet reale për të lehtësuar krahasimin ndërmjet planifikimit dhe zbatimit të buxhetit. Kjo mund të ndihmojë në identifikimin e fushave ku qeveria mund të përmirësojë efikasitetin dhe efektivitetin e shpenzimeve, si dhe të evidentojë ato fusha ku resurset që nuk janë shfrytëzuar plotësisht mund të përdoren për të avancuar barazinë gjinore.

Tabela 5. Alokimet dhe zbatimi i buxhetit në nivel qendror

Institucioni (Total)	Shuma e alokuar	Shuma e shpenzuar	Krahasimi %
Kuvendi	10,548,018	8,808,620	-16%
Zyra e Presidentit	4,213,791	3,739,995	-11%
ZKM	22,395,572	22,435,186	0%
MFPT	882,702,203	905,285,238	3%
MFPT - Rezerva buxhetore	48,323,760	10,827,514	-78%
Ministria e Bujqësisë	89,833,563	95,575,823	6%
Ministria e Industrisë	24,779,272	23,641,946	-5%
Ministria e Mjedisit	265,445,995	264,568,135	0%
Ministria e Shëndetësisë	80,395,329	67,657,690	-16%
MKRS	88,118,721	82,776,628	-6%
Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit	100,120,951	100,773,161	1%
Ministria për Komunitete dhe Kthim	6,639,660	7,040,324	6%
MAPL	9,541,135	14,800,379	55%
Ministria e Ekonomisë	58,627,892	77,018,362	31%
Ministria e Punëve të Brendshme	216,523,467	238,803,951	10%
Ministria e Drejtësisë	47,041,887	43,051,539	-8%
Ministria e Punëve të Jashtme dhe Diasporës	47,483,313	42,432,942	-11%
Ministria e Mbrojtjes	153,049,911	175,175,120	14%
University Clinical Hospital Service of Kosovo Shërbimi Spitalor Universitar i Kosovës	174,387,768	173,706,785	0%
Ministria e Zhvillimit Rajonal	6,889,574	5,824,579	-15%
Fondi i Sigurimeve Shëndetësore	8,877,671	12,723,112	43%
Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik	955,713	786,852	-18%
Akademia e Shkencave dhe e Arteve të Kosovës	1,672,045	1,678,661	0%
Shpenzime të paparashikuara	11,699,000	3,946,139	-66%
REZERVA	9,769,000	2,536,139	-74%
Autoriteti Rregullativ për Komunikime Elektronike dhe Postare	1,546,894	1,548,620	0%
Agjencia Kundër-Korrupsionit	965,660	782,473	-19%
Zyra e Rregullatorit për Energjisë në Kosovë	898,761	798,918	-11%
Agjencia e Privatizimit të Kosovës	4,575,686	4,704,686	3%
Organi Shqyrtues i Prokurimeve	502,939	420,099	-16%
Universiteti i Prishtinës	31,710,072	31,392,362	-1%
Gjykata Kushtetuese	1,992,123	2,103,441	6%
Autoriteti i Konkurrencës	402,209	400,531	0%
Agjencia e Kosovës për Inteligjencë	14,249,733	12,807,056	-10%
Këshilli i Kosovës për Trashëgimi Kulturore	269,153	237,240	-12%
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa	239,917	180,306	-25%
Radio Televizioni i Kosovës	8,960,000	8,960,000	0%

Institucioni (Total)	Shuma e alokuar	Shuma e shpenzuar	Krahasimi %
Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës	421,794	398,467	-6%
Këshilli Prokurorial i Kosovës	17,265,867	15,733,092	-9%
Agjencia për Informim dhe Privatësi	474,049	440,852	-7%
Agjencia e Shërbimeve të Navigacionit Ajror	9,319,409	8,699,409	-7%
Agjencia për Mbrojtjen e Informacionit të Klasifikuar	321,560	260,175	-19%
Zyra Kombëtare e Auditimit	3,345,655	3,066,474	-8%
Autoriteti Rregullator i Shërbimeve të Ujit	475,806	450,152	-5%
Autoriteti Rregullator i Hekurudhave	423,714	362,661	-14%
Autoriteti i Aviacionit Civil	687,168	766,894	12%
Komisioni i Pavarur për Miniera dhe Minerale	1,515,316	1,513,858	0%
Komisioni i Pavarur për Mediat	1,810,286	1,717,899	-5%
Komisioni Qendror i Zgjedhjeve	9,874,494	10,099,182	2%
Institucioni i Avokatit të Popullit	1,300,018	1,238,846	-5%
Akademia e Drejtësisë	863,245	735,600	-15%
Këshilli Gjyqësor i Kosovës	35,806,910	35,786,628	0%
Agjencia Kosovare për Krahasim dhe Verifikim të Pronës	2,613,969	2,369,947	-9%
Niveli qendror – Gjithsej	2,513,098,616	2,531,054,55	1%

Tabela 6. Niveli lokal – Alokimi dhe zbatimi i buxhetit

Komuna (Totali)	Buxheti i alokuar	Buxheti i zbatuar	Krahasimi %
Drenas	20,968,992	23,622,785	13%
Fushë Kosovë	16,285,500	23,827,557	46%
Lipjan	23,053,202	25,253,734	10%
Obiliq	14,248,389	14,612,754	3%
Podujevë	31,268,469	34,041,607	9%
Prishtinë	123,699,999	171,702,510	39%
Shtime	10,200,510	11,153,675	9%
Graçanicë	8,985,460	9,886,126	10%
Dragash	12,110,967	12,336,546	2%
Prizren	66,201,979	70,441,123	6%
Rahovec	19,804,786	21,801,774	10%
Suharekë	22,084,868	24,818,348	12%
Malishevë	19,740,806	21,701,931	10%
Mamushë	2,565,143	2,655,048	4%
Deçan	13,508,082	14,778,315	9%
Gjakovë	37,483,964	42,459,303	13%
Istog	15,141,743	16,571,740	9%
Klinë	14,648,717	15,746,411	7%
Pejë	37,457,026	41,859,909	12%
Junik	2,199,837	2,374,083	8%
Leposaviq	5,832,216	2,733,067	-53%
Mitrovicë	28,408,510	30,800,459	8%
Skenderaj	18,582,311	20,500,265	10%
Vushtrri	26,770,039	29,358,260	10%
Zubin Potok	3,428,092	2,332,937	-32%
Zveçan	3,278,670	2,163,217	-34%
Mitrovicë e Veriut	6,367,531	2,718,631	-57%
Gjilan	37,189,018	41,235,960	11%

Kaçanik	11,958,982	12,855,089	7%
Kamenicë	14,523,816	16,995,290	17%
Novobërdë	3,925,195	4,271,145	9%
Shtërpcë	4,622,800	4,769,578	3%
Ferizaj	41,184,014	42,966,691	4%
Viti	16,653,192	19,431,801	17%
Partesh	1,549,954	1,642,990	6%
Han i Elezit	3,349,278	3,548,177	6%
Kllokot	1,397,829	1,502,873	8%
Ranillug	2,235,239	2,347,290	5%
Gjithsej	742,915,125	843,818,999	14%

Shtojca 3. Arritja e treguesve të PKBGj

Kjo shtojcë përmban informacion mbi arritjen e treguesve të PKBGj, duke përfshirë numrin e treguesit, një përshkrim të shkurtër, synimin për vitin 2024, arritjen më të fundit të raportuar dhe nivelin e arritjes, siç është raportuar nga ABGj. Treguesit janë renditur sipas secilës shtyllë.

#	Treguesi (përshkrim i shkurtër)	Synimi 2024	Arritja e fundit e raportuar	Tregues të arritur
Shtylla I: Fuqizimi ekonomik dhe mirëqenia sociale				
1	Norma e punësimit të grave (mosha 15-64)	20 %	19.8 % (2023)	
2	Norma e varfërisë (popullata e përgjithshme)	13 %	Nuk ka të dhëna	Nuk ka të dhëna
3	Pjesëmarrja e grave në tregun e punës	40 %	24.2 % (2023)	Jo
4	Pjesa e bizneseve aktive në pronësi ose bashkë-pronësi nga gra	18 %	18 % (ARBK 2023)	Po
5	RPAPT (Të rinjtë 15-24 vjeç që nuk janë të përfshirë në arsim, punë ose trajnim)	20 %	33.9 % (vajza) / 32.9 % (djem) (2023)	Jo
6	Pjesa e pronave në pronësi ose bashkë-pronësi nga gra	25 %	19.8 % (Jan 2024)	Jo
7	Politika publike me perspektivë gjinore të integruar	40 % e politikave të reja	Nuk ka të dhëna	Nuk ka të dhëna
8	Fonde publike nga të cilat përfitojnë gratë	40 %	Nuk ka të dhëna	Nuk ka të dhëna
9	Norma e punës joformale (jo-bujqësore)	8 %	9 % (2023)	Jo
10	Familjet e varfra të mbuluara nga skemat e asistencës sociale	70 %	Nuk ka të dhëna	Nuk ka të dhëna
Shtylla II: Zhvillimi njerëzor, roli dhe marrëdhëniet gjinore				
11	Drejtoresha të shkollës (arsimi para-universitar)	50 %	35.8 % (2022-2023)	Jo
12	Tekstet e rishikuara dhe modifikuara për stereotipet gjinore	100 %	Disa tekste të rishikuara (Gjuha shqipe, matematika); % përqindja nuk është gjetur	Nuk ka të dhëna
13	Përfshirja e fëmijëve 0-4 vjeç në arsim parashkollor	6 %	7.2 % (2022/23)	Po
14	Gratë (25-64 vjeç) që përfundojnë arsimin e lartë	30 %	19.3 % (2023)	Jo
15	Pjesëmarrja e fëmijëve rom, ashkali dhe egjiptian në arsim	+10 % (arsim i detyrueshëm) /	(nuk ka të dhëna sasiore)	Nuk ka të dhëna

		+20 % (arsimi i mesëm i lartë)		
16	Programet e arsimit të lartë me perspektivë gjinore	15 programe	17 programe (Universiteti i Prishtinës)	Po
17	Sistemi operativ i monitorimit të imazhit të grave në media	Sistemi funksional dhe 6 studime hulumtuese	Nuk është funksional	Jo
18	Klube sportive të drejtuara nga vajzat	6 klube	Nuk ka të dhëna	Nuk ka të dhëna
19	Pjesa e buxhetit për sport e alokuar për vajza	50 %	Nuk ka të dhëna	Nuk ka të dhëna
20	Të dhëna personale shëndetësore të integruara në sistemin informativ	Sistemi operativ	Pilotuar vetëm në disa komuna	Jo
21	Vizitat në shtëpi për nënat/fëmijët (post-natal)	30 % e grupit të synuar	36 336 vizita të regjistruara (pa përqindje të llogaritur)	Nuk ka të dhëna
22	Edukimi për shëndetin seksual dhe riprodhues në shkolla	100 % e kurrikulës u zbatua	Janë përfshirë kurrikulat; 60 % e mësimdhënësve u trajnuan; u hartuan udhëzues për mësimdhënësit	Pjesërisht
23	Lindjet tek adoleshentet (mosha 10-14 dhe 15-19)	190 lindje totale	2 lindje (10-14) dhe 338 lindje (15-19) (2023)	Jo
Shtylla III: Të drejtat e grave, qasja në drejtësi dhe siguri				
24	Gratë e punësuara në ministritë qendrore dhe agjencitë ekzekutive	40 % e pozitive	45.6 % (2024)	Po
25	Rastet e dhunës në familje të trajtuara nga sistemi gjyqësor	100 %	Nuk ka të dhëna	Nuk ka të dhëna
26	Masa afirmative shtesë të ndërmarra nga institucionet	I masë shtesë	I masë shtesë (Ministria e Ekonomisë – MASHTI)	Po
27	Aplikimet e shqyrtuara nga Komisioni i Verifikimit	100 %	98 % (2023-24)	Po
28	Gratë në pozita menaxheriale/drejtuese në qeverinë qendrore	30 %	23.1 % (Dec 2023)	Jo
29	Gratë në pozicione menaxheriale/drejtues (nivel komunal)	30 %	40.8 % (2024)	Po
30	Gra deputete në Kuvendin e Kosovës	50 %	33 % (2024)	Jo
31	Gra deputete në kuvendet komunale	50 %	37 % (2022)	Jo
32	Gratë në Forcën e Sigurisë së Kosovës (FSK)	15 %	9.2 % (2024)	Jo
33	Gratë në Policinë e Kosovës	20 %	14.8 % (2024)	Jo
34	Gjyqtare në sistemin e drejtësisë	50 %	34.6 % (2024)	Jo
35	Gratë në misione diplomatike jashtë vendit (përfshirë ato të policisë dhe ushtrisë)	50 %	36 % (2024)	Jo
36	Politika ndëshkuese për dhunën me bazë gjinore dhe trafikimin	Përfunduar	Statusi i paqartë / nuk është raportuar	Nuk ka të dhëna

